

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij Memorandumi është mbrojtja efektive nga diskriminimi apo çdo formë tjetër sjelljeje që nxit diskriminimin përmes dhënies me përparësi të ndihmës juridike të realizuar nga bashkëpunimi i ndërsjellë dhe bashkërendimi ndërmjet Palëve, për të ofruar me përparësi, cilësi, efikasitet dhe profesionalizëm, si dhe në të gjitha format, shërbimin e ndihmës juridike në çështjet që lidhen me shkeljen e të drejtës për barazi para ligjit.

Neni 2

Forma e bashkëpunimit

Bashkëpunimi sipas këtij Memorandumi realizohet nëpërmjet:

1. Bashkërendimit në dhënien e informacionit për sistemin ligjor në Republikën e Shqipërisë, për aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit, mënyrat e ushtrimit të të drejtave të individit, në proceset gjyqësore dhe ato jashtëgjyqësore, si dhe dhënia e asistencës në hartimin e dokumenteve juridike apo në forma të tjera, sipas rasteve të raportuara për çështjet që lidhen me diskriminimin.
2. Bashkërendimit në dhënien e shërbimeve të këshillimit, përfaqësimit apo mbrojtjes në proceset gjyqësore, apo edhe në rastet e paraqitjes para organeve administrative shtetërore, në të cilat shqyrtohen në rrugë gjyqësore apo administrative, sipas rastit, çështjet që lidhen me diskriminimin.
3. Pjesëmarrjes në grupet e punës për të dhënë mendime në hartimin e udhëzimeve për avokatët e autorizuar në dhënien e ndihmës juridike për çfarë do lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin.
4. Shkëmbimit të vlerësimeve të punës së avokatëve të autorizuar për ofrimin e ndihmës juridike, për çështjet që lidhen me diskriminimin.
5. Nxitjes dhe marrjes së masave mbi sensibilizimin e publikut dhe edukimin e tij, mbi ndihmën që ofrohet për çështjet që lidhen me diskriminimin, nëpërmjet klinikave lëvizëse, publikimeve, fushatave televizive dhe medias së shkruar.
6. Programimit të takimeve periodike për shkëmbimin e informacionit mbi aktivitetet e realizuara dhe bashkërendimin e atyre aktiviteteve që vlerësohen të nevojshme për t'u ndërmarrë në të ardhmen, të cilat do të jenë rrjedhojë e situatave të ndeshura në praktikë.
7. Shkëmbimin e përbashkët të statistikave që kanë për bazë numrin e rasteve të raportuara dhe të trajtuara nga avokatët e autorizuar për dhënien e ndihmës juridike me qëllim analizimin e tyre për hartimin e politikave të mëtejshme të nevojshme për përmirësimin e aksesit në drejtësi dhe barazisë para ligjit.

8. Kryerjes së analizave dhe studimeve të përbashkëta me qëllim nxjerrjen e rekomandimeve të karakterit ligjor dhe administrativ dhe vënien e tyre në dispozicion të Ministrisë së Drejtësisë, e cila do të vlerësojë nevojën dhe formën e ndërhyrjeve konkrete.

Neni 3

Komunikimi mes palëve

1. Palët angazhohen të mbajnë një komunikim të vazhdueshëm ndërmjet tyre dhe të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e detyrave të tyre. Komunikimi do të kryhet në formë shkresore dhe në raste të veçanta edhe në rrugë elektronike.
2. Palët do të caktojnë një person kontakti që do të jetë përgjegjës për zbatimin konkret të Memorandumit dhe të shkëmbimit të statistikave.
3. Personat e kontaktit nga të dyja palët do të jenë të disponueshëm në çdo kohë për komunikimin dhe koordinimin me palën tjetër me qëllim rakordimin e veprimeve që duhet të ndërmerren rast pas rasti.
4. Me anë të përfaqësuesve të dyja palët do të përcaktojnë radhën e mbledhjeve të grupeve të punës, kohëzgjatjen dhe periodicitetin e këtyre mbledhjeve.

Neni 4

Ndryshimi i Memorandumit

Ky Memorandum mund të ndryshojë vetëm me marrëveshje të palëve nëpërmjet shkëmbimit të komunikimit me shkrim.

Neni 5

Përfundimi i Memorandumit

1. Memorandumi lidhet pa afat, por mund të përfundojë në çdo kohë. Përfundimi hyn në fuqi një muaj pas marrjes së njoftimit me shkrim nga Pala tjetër.
2. Deri në përfundimin e këtij Memorandumi, palët do t'u përmbahen kushteve që rrjedhin nga ky Memorandum, përsa i përket informacionit dhe dokumentave të shkëmbyera përpara datës së përfundimit të saj.

Neni 6

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e këtij Memorandumi do të zgjidhet me mirëkuptim mes palëve.

Neni 7

Hyrja në Fuqi

Memorandum i Bashkëpunimit hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj.

Memorandumi përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në Ministrinë Drejtësisë për Komisionin Shtetëror të Ndhmës Juridike dhe dy të tjera në Zyrën e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Ky Memorandum Bashkëpunimi nënshkruhet sot në Tiranë, më datë 01/04/2011.

**PËR
KOMISIONIN SHTETËROR PËR
NDIHMË JURIDIKE**

**KRYETARE
BLEGINA AGOLLI (KODRA)**


(nënshkrimi)

**PËR
KOMISIONERIN PËR MBROJTJEN
NGA DISKRIMINIMI**

**KOMISIONERE
IRMA BARAKU**


(nënshkrimi)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI SHTETËROR PËR
NDIHMËN JURIDIKE**

Nr. 1 Prot., Datë 01/04/2011

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN
NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 43 Prot., Datë 14/4/2011

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

KOMISIONIT SHTETËROR PËR NDIHMË JURIDIKE

DHE

KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Komisioni Shtetëror për Ndhmën Juridike dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (të quajtura në vijim "Palë"):

Duke vlerësuar rëndësinë e promovimit, garantimit dhe respektimit të të drejtave të të gjithë individëve përpara ligjit dhe mekanizmave zbatuese të tij, pa asnjë lloj dallimi apo shkak;

Duke konfirmuar angazhimin maksimal për të siguruar të gjitha mjetet e nevojshme të ndihmës juridike për të bërë të mundur mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë që nxit diskriminimin;

Duke konsideruar si objektiv prioritar në ushtrimin e veprimtarisë së tyre realizimin e interesave të ligjshëm të individëve mbështetur në parimet e barazisë përpara ligjit dhe ruajtjes së konfidencialitetit;

Duke u mbështetur në kuadrin ligjor që normon veprimtarinë tyre institucionale dhe administrative: në ligjin nr. 10 039, datë 22.12.2008 "Për ndihmën juridike" dhe në ligjin nr. 10 221, datë 4.2.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi";

Kanë rënë dakord të lidhin këtë Memorandum Bashkëpunimi (në vijim "Memorandum").